



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.3268/12 prot.

Datë 10.12.2025

V E N D I M
Nr. 1833/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10.12.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.1699/2025, datë 18.11.2025, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-62195-09-22-2025, me objekt “Blerje zjarrefikese per nevoja te bashkise Shijak”, me fond limit 10,000,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 09.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shijak

Ankimues: Operatori ekonomik “Luar Bros” SHPK me NIPT L72322004M dhe adresë: Rruga Ali Demi , Kompleksi Vind, Shkalla B, Kati 4, Apartamenti 11, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Shijak me adresë: Lagja “Erzen” Shijak

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 18.11.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.1699/2025, ku vendosi:

1. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Luar Bros” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-62195-09-22-2025, me objekt “Blerje zjarrefikese per nevoja te bashkise Shijak”, me fond limit 10,000,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 09.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shijak.
2. Autoriteti kontraktor të zbatojë vendimin e KSHA-së me nr. 396 datë 17.11.2025 të ngarkuar në sistemin e ankesave elektronike dhe protokolluar me tonën me nr. 3268/2 prot., datë 18.11.2025.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të njoftojë KPP mbi zbatimin e vendimit të KSHA duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Luar Bros” SHPK.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr.6025 prot., datë 04.12.2025 me lëndë “Dërgim i vazhdimit të procedurës në sistem të SPE”, protokolluar me tonën me nr.3268/8 prot., datë 05.12.2025 autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 1699/2025 datë 18.11.2025.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr.6025 prot., datë 04.12.2025 me lëndë “Dërgim i vazhdimit të procedurës në sistem të SPE”, protokolluar me tonën me nr.3268/8 prot., datë 05.12.2025 autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 1699/2025 datë 18.11.2025.

II.2. Nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik duke kualifikuar operatorin ekonomik “Luar Bros” SHPK në përputhje me vendimin e KSHA-së së autoritetit kontraktor për të cilin sipas parashikimeve të nenit 115 të LPP-së, KPP me vendimin nr.1699/2025, datë 18.11.2025 ka mbyllur çështjen.

II.3. Sa më sipër, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor, ka zbatuar vendimin e KSHA-së së tij për të cilin sipas parashikimeve të nenit 115 të LPP-së, KPP me vendimin nr.1699/2025, datë 18.11.2025 ka mbyllur çështjen për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-62195-09-22-2025, me objekt “Blerje zjarrefikese per nevoja te bashkise Shijak”, me fond limit 10,000,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 09.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shijak.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-62195-09-22-2025, me objekt “Blerje zjarrefikese per nevoja te bashkise Shijak”, me fond limit 10,000,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 09.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shijak.
 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar	Anëtar	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anila Malaj	Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

